

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, gjyqtari Alban Beqiri çështjen juridike të paditëses [REDACTED] S [REDACTED]. me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson [REDACTED], me autorizim kundër të padituri [REDACTED] nga Ferizaj, rr." [REDACTED], në çështjen juridike rimbursim dëmi-regres, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur, më datë 07.11.2016, në prezencën e përfaqësueses të paditëses dhe në mungesë të paditurit mori këtë:

AKT GJYKIM

- I. **APROVOHET** në tërësi kërkesë padia e paditëses [REDACTED], si e bazuar,
- II. **DETYROHET** i padituri [REDACTED] nga Ferizaj, rr." [REDACTED], që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit-regresit t'i paguajë shumën prej 162.00 € (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro), me kamatën ligjore, prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë datë 18.03.2015, deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 30 €, të gjitha në afat prej 7 dite, pas marrjes së formës së prerë të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Përfaqësuesi i paditëses në fjalën e tij ka deklaruar se bëjë precizimin subjektiv të kërkesëpadisë, pasi që [REDACTED] është shuar, dhe tani e tutje si paditëse duhet të jetë [REDACTED], duke shtuar se mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, meqenëse baza juridike si dhe lartësia e saj, nuk është kontestuese, pasi që e njëjta është argumentuar me prova materiale të njëjtën i propozoj gjykatës që ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata ne baze të nenit. 409.2 të LPK- së, ka mbajtur seancën në mungesë të paditurit pasi që i njëjti ftesën e ka pranuar në mënyrë të rregullte, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe shtyrjen nuk e ka kërkuar.

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike ka bërë nxjerrjen e provave: U lexua padia e paditësve C.nr. 160/15 dt.18.03.2015, Autorizimi i paditëses dhënë av. [REDACTED] dt.30.09.2014, Raporti i policisë 2013-CT-634 dt.25.03.2013, Kërkesa e paraqitur nga i dëmtuari A [REDACTED] në procedurë administrative pranë paditëses dt.27.03.2013, Bëhet shiqimi i dëshmisë së pagesës të bërë të dëmtuarit nga ana e paditëses më dt.07.05.2013, Ftesa e bërë nga paditësja për tani të paditurin nr. 656/14 dt.14.04.2014, ë procedurë jashtë gjyqësore, Njoftimi të dërguar të paditurit përmes postes dt.15.04.2014, Marrëveshja jashtëgjyqësore e lidhur në mes paditësit dhe të dëmtuarit dt.12.04.2013, Njoftimi për ofertë të dhënë nga paditësja për të dëmtuarin [REDACTED] nr.552/13 dt.10.04.2013, Autorizimi i paditëses dhënë të autorizuarit [REDACTED].

Bazuar në provat e administruara dhe vlerësimit të tyre, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata ka vërtetuar se kërkesë padia është e bazuar.

Gjykata me rastin e vlerësimit të bazueshmërisë së kërkesëpadisë, konsideron se e njëjta bazohet në provat e e administruara dhe atë raportit të policitë hetues me nr. Rasti 2013-CT-634 dt.25.03.2013, gjykata ka vërtetuar se është shkaktuar aksidenti i komunikacionit në Ferizaj në të cilin në aksident kanë marr pjesë vetura e tipit VW GOLF TDI, me targa të regjistrimit [REDACTED], ka shkaktuar aksident trafiku ne Ferizaj me ç'rast automjeti me të cilin i padituri ka shkaktuar aksident trafiku ka goditur automjetin Ford Fokus me targa të regjistrimit [REDACTED] me të cilin të dëmtuarit i ka shkaktuar lartësinë e dëmit të aprovuar në kërkesë padinë.

Gjykata lidhur me lartësinë e dëmit material ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në kuptim të nenit 323 LPK-së dhe në dispozitat e nenit 136,159 të LMD-së lidhur me dhe nenit 18 të Ligjit për Sigurimet e Detyrueshme, sepse rasti i siguruar nuk ka qenë i siguruar meqenëse rasti nuk është i mbuluar me polis të sigurimit dhe ka detyruar të paditurin të bëjë regresimin e dëmit në shumë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u



bazuar në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, pasi që paditësja ia ka përmbushur të dëmtuarin dëmin e shkaktuar në aksidentin e komunikacionit siq shihet nga marrëveshja gjyqësore dhe nga transferi bankar.

Gjykata me rastin e vendosjes sipas detyrës zyrtare gjithnjë është kujdesur sa i përket bazës juridike kërkesë padisë pasi që i padituri nuk është paraqitur në gjykatë por nuk ka pasur bazë për të vendosur ndryshe.

Gjykata në lartësinë e aprovuar të shpërblimit të dëmit material, paditësit ja ka njohur të drejtën në kamatë ligjore prej 8 % nga ditës së ushtrimit të padisë dt. 18.03.2015, deri në pagesën definitive si për mjetet e deponuara në banka mbi një vit, pa destinim të caktuar, në kuptim të nenit 382.2 të LMD-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka bazuar në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, andaj i padituri obligohet të paguaj 30 € dhe atë për taksë gjyqësore për padi shumën prej 15€ dhe aktgjykim prej 15€, e cila është llogaritur në bazë të shumës së aprovuar të kërkesëpadisë.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.160/15, dt.07.11.2016



Gjyqtari
Iban Beqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar të kërket ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC.

